Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Xhevdet Bushi, ***Eksperti shqyrtues i jashtëm***	**29.04.2022**	**04.05.2022**	Nr. i lëndës: **113/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.04.2022, OE. Ipko Telecommunications L.L.C– Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **113/22**, kundër Njoftimit mbi Anulimin e aktivitetit te Prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sherbime te telefonisë mobile – kontratë tre vjeçare"** me nr te prokurimit**: 632-22-2113-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – **Komuna e Gjakovës (KGj).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, lloji i kontratës: **Sherbime**, vlera e parashikuar e kontratës: **60,000.00 €**.

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i **OSHP-së)**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

TE DHENAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

Njoftimi për kontratë: 18.03.2022
Kerkesa per rishqyrtim: 06.04.2022 (Telekomi i Kosovës – VALA)
Anulimi i aktivitetit: 12.04.2022

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE – 109/22

Shpallja e procedurës ne e-prokurim:
Dispozitat e shkeluara te AK-se
Neni 1 i LPP-se;
Neni 2 i LPP-se, paragrafi 1;
Neni 7 i LPP-se, paragrafi 1,2,4 dhe 6;
Neni 56.1 i LPP-se;

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.
Pretendimet ankimore te OE ankues

Vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Shërbimet e telefonisë mobile – kontratë tre vjecare", Nr.prok.632-22-2113-2-2-1, Nr.i brendshem: 632-22-004-221, është marr shkelje flagrante e Ligjit

mbi Prokurimin Publik, në fuqi. Gjegjësisht vendimi në fjalë konsiston në shkelje të:

- Qëllimi i ligjit të prokurimit publik, i cili është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente, më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe të gjitha fondeve të autoriteteve kontraktuese duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë aktivitetet e prokurimit; të sigurojnë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet të tilla, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
- Kërkesat përmbajtësore të ligjit mbi prokurimin publik;
- Të barazisë në trajtim dhe jo diskriminim, pasi që autoriteti kontraktues ka dështuar të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese, ashtu që ka lejuar që aktiviteti i prokurimit të zhvillohet në atë mënyrë, që redukton dhe eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ka imponuar krijimin e rrethanave dhe kushteve që rezultojnë në diskriminimin e operatorëve ekonomik, kështu duke bërë diskriminim në dëm të IPKO-së, e në të mirë të operatorit Telekomi i Kosovës . Rrjedhimisht duke dështuar të eliminoj praktikat që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik;
- Të nenit 56.1, me anë të të cilit përcaktohet se të gjitha kontratat publike, do të ipen sipas procedurave të themeluara për seleksionim, me anë të së cilës nënkuptohet se aktiviteti i prokurimit në fjalë, duhet që të vlerësoj tenderët në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në bazë të LPP.

Anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë, për më tepër konsiston në aplikimin e gabuar të neneve përkatëse të LPP-së, rrjedhimisht në aplikim të gabuar të nenit 9.4, i cili parasheh se "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i till publik duhet të marr masa të arsyeshme, për tu siguruar që lëndët që i përmbushin këto nevoja, nuk janë në dispozicion nga një autoritet tjetër publik". Theksojmë se konsiderimi i operatorit ekonomik Telekomi i Kosovës, si autoritet publik nuk mund të qëndroj, marr për bazë faktin se i njëjti është operator në pronësi publike, e jo autoritet publik.

Përmbi të gjitha, vendimet e tilla, për anulim të aktivitetit të prokurimit si pasojë e aplikimit të gabuar të nenit 9.4, si më sipër, kanë krijuar polemika sa i përket keqinterpretimit të saj, dhe atë si rrjedhojë e vendimit 05/21, të datës 02.04.2020 për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit të Prokurimit Publik të shërbimeve telekomunikuese që ofron Telekomi i Kosovës, si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore, në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.1 të Ligjit për Prokurimin Publik. Sidoqoftë, këto polemika kanë rezultuar drejtë anulimit të së njëjtës, përmes vendimit nr.05/34 dt.07.10.2020, pasi që është konstatuar se - si rrjedhojë e ndalimit të konkurrencës së lirë të garantuar me kushtetutë, është vendim i jashtëligjshëm, konsideruar poashtu faktin se shërbimet e ofruara nga Telekomi i Kosovës, nuk përbëjnë shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore . në këtë drejtim vendimi për shfuqizim, në mënyrë taksative obligon të gjitha institucionet të veprojnë në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik dhe ti ndjekin në mënyrë strikte të gjitha procedurat e

përcaktuara me Ligj dhe të mos kryejnë procedura të prokurimit sipas nenit 3 të LPP-së, pa Vendim të Qeverisë. Pra, me anulimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë, IPKO po i nënshkrohet një diskriminimi, i cili në masë dëmton IPKO-në, kështu duke mohuar të drejtën në ofrimin e shërbimeve për të cilat është licencuar.
DËMET MATERIALE IPKO Telecommunications LLC konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues, janë veprime jo-ligjore dhe dëmtojnë IPKO-në në fitimin e humbur sepse këto praktika mbështesin konkurrencën jo lojale duke diskriminuar dhe duke përjashtuar IPKO Telecommunications LLC nga një konkurim lojal dhe duke e vendosur atë në pozitë diskriminuese ndaj konkurrentit Telekomi i Kosovës, kështu duke i pamundësuar IPKO Telecommunications LLC ngritjen e numrit të përdoruesve që marrin shërbimet e IPKO Telecommunications L.L.C

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04 L-237, ligjin nr. 05 L-068 dhe ligjin nr. 05 L-092 , neni 65Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.	**Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.**
Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës.	**Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues).**
Vërtetim nga Gjykata kompetente.	**Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).**

Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit	**Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).**

Certifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK	**Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).**
Licencë për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile e lëshuar nga institucioni kompetent në Republikën e Kosovës	**Licencë për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile e lëshuar nga institucioni kompetent në Republikën e Kosovës- (kopje)**
Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të cilat dëshmojnë se ka kryer shërbime të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.	**Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha shërbimet e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar shërbimet e kryera shumën e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mire të shërbimeve – (së paku një referencë ose raport të pranimit të shërbimeve e cila përputhet me listën e dorëzuar),në rast kur OE prezenton kontrata-referenca me OE privatë atëherë OE duhet te prezentohen situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontrate-referencë.**

Kriteret e kerkuara nga AK-ja (per pretendimet qe ka OE ankues):

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES – N/A

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni ri-vlerësues ka konstatuar si në vijim:
Filloi N/A
Perfundoi N/A
(Tëpërshkruhetvetëmvlërësimi i ofertëssë OE ankues /ofertave, përtë cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

--

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- **NA**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PERGJIGJE NE PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES: 113/22

Përgjigje në pretendimin ankimor

OE ankues IPKO Telecommunications LLC, nuk i ka respektuar shkallët ankimore duke mos e shfrytëzuar nenin 108/A të LPP-së, që thotë se së pari duhet të bëhet ankesë në Autoritet dhe pas pranimit të përgjigjes brenda afatit 10 ditor të bëhet ankesë në OSHP sipas nenit 109 të LPP-së. Pra,

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Paragrafi 1 i nenit 108/A të LPP-së thotë: ***Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.***

Paragrafi 3 i nenit 108/A të LPP-së thotë: Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

*3.*1. në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

*3.*2. në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

3.3. në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

Pra, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues do ta shqyrton sipas paragrafit 6 të nenit 108/A të LPP-së që thotë: Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Kurse, në rast se Operatori nuk është i kënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues, duhet të veproj sipas paragrafit 7 të nenit 108/A që thotë: Kundër vendimit të autoritetit kontraktues, ankuesi mund të paraqesë një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.

Poashtu, paragrafi 1 dhe 2 i nenit 109 i LPP-së (Afatet për dorëzimin e ankesës) thotë:

Paragrafi 1 i nenit 109 të LPP-së thotë: Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm **pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.**

Paragrafi 2 i nenit 109 të LPP-së thotë: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Pra, OE IPKO Telecommunications LLC, nuk i ka respektuar shkallët e ankimimit, së pari duke respektuar nenin 108/A të LPP-së që pas pranimit të përgjigjes nga Autoriteti Kontraktues sipas paragrafit 10 të nenit 108/A, brenda afatit 10 ditor të bëj ankesë pranë OSHP-së.

Bazuar në sqarimet e paraqitura si më lartë, mendoj se ankesa e OE IPKO Telecommunications LLC të hudhet si e palejuar, për shkak se si ankues nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore – shkallët e ankimimit që ankesa të bëhet së pari në autoritet kontraktues sipas nenit 108/A të LPP-së, e më pastaj në OSHP sipas nenit 109 të LPP-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE-së të hudhet si e pa lejuar për shkak se nuk i ka respektuar shkallët e ankimimit, ku ankuesi nuk ka bërë fare kërkesë për rishqyrtim sipas nenit 108/A të LPP-se dhe më pas për të vazhduar me ankesë sipas nenit 109 të LPP-së.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **AK-Komuna e Gjakovës**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues - **OE. IPKO Telecommunications LLC**